


THUAJE ZËSHËM,



ËSHTË MENDIMI YT

## NE E DUAM DEMOKRACINË

**SHPEND (10), ARDI (10), ALBERTA (10), ATDHEU (10), BLERTI (10), ARDIANI (11)**



### Demokracia ka shumë gjëra pozitive brenda vetes, siç janë respektimi i të drejtave në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë dallim

Ne klasa V-2 jemi të kënaqur që kemi një shtet demokratik. Shtrohet pyetja se çfarë është demokracia? Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje apo rend. Pra, populli është ai që merr vendime në vendin e vet, qoftë me anë të përfaqësuesve apo mënyrave të tjera. Në vendin tonë kemi demokraci përfaqësuese, ku përfaqësuesit tanë janë deputetët, të cilët zgjedhen përmes votave tona.

Demokracia ka disa elemente shumë të rëndësishme, siç është respekti. Për shembull, ne në klasën tonë e respektojmë mësuesen dhe arsimtarët, ndërsa nxënësit respektojnë njëri-tjetrin. Kjo ndodh sepse duhet të jemi të mirë dhe të sjellshëm, përderisa kalojmë aq kohë së bashku. Element tjetër është paqja, e cila nënkupton qetësinë shpirtërore të njeriut, e kjo bëhet duke iu shmangur konflikteve dhe luftës, pra me marrëveshje dhe me bisedime. Liria si element i rëndësishëm është në kundërshtim me dhunën, vrasjet e gjëra të tilla që nuk janë njerëzore.

Lexues të dashur, respektojeni shtetin tuaj, punoni për ta ngritur dhe forcuar atë, sepse ne jemi ata që mund të bëjmë mrekulli me vendin tonë duke treguar se sa të mençur jemi, sa talente kemi dhe se sa të aftë jemi.



**Duke i kryer punët që i kemi ndarë në grup**




**Gazetarët e demokracisë**




Ne jemi pjesë e Tokës



Të kontribuojmë për një demokraci të plotë



Demokracia dhe elementet e saj



E drejta e votës



Në demokraci nuk ka dallime



Kushtetuta e Kosovës

# TË GJITHË E KEMI TË DREJTËN E VOTËS

KLODIANA (10), EGZON (12), ADRIAN (10), BLERTINA (11), GRAMOS (11), DREN (10)

**Pse janë të rëndësishme zgjedhjet në një shtet demokratik? Nga cila moshë e gëzojmë të drejtën e votës? Cilat janë llojet e zgjedhjeve në Kosovë? Cili është roli ynë në demokraci? Këto informacione do t'i mësoni në artikullin më poshtë**

Me anë të zgjedhjeve, populli ka të drejtën e të shprehurit lirshëm mendimin e vet. Shprehja e lirë e mendimit është demokraci. Ndërsa, zemra e demokracisë janë zgjedhjet, sepse përmes procesit të votimit secili qytetar mbi moshën 18 vjeçare mund ta ushtrojë sovranitetin e tij duke zgjedhur kështu 120 deputetë. Këta deputetë propozojnë dhe miratojnë ligje në Kuvend. Kurse, këto ligje kanë ndikim të madh në jetën tonë duke e lehtësuar mënyrën e jetesës për qytetarët. Në Kosovë janë dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe zgjedhjet lokale. Dalja në zgjedhje është përgjegjësi e çdo qytetari aktiv, i cili mendon për të mirën e shtetit të tij. Prandaj, ju ftojme edhe juve që të votoni dhe ta ndihmoni vendin që të zhvillohet edhe më shumë.




Gazetarët e „Demos-ti“



Kosova realizon zgjedhje demokratike



Deputeti i zgjedhur nga votat e popullit




Të drejtën e votës e kemi në moshën 18 vjeçare



Vota bën ndryshim, prandaj voto edhe ti

# POPULLI UDHËHEQ


AULONA (10), ENIS (11), FATGZON (11), GENTA (10), RINOR (11)



## Kuvendi është institucion i cili është i udhëhequr nga përfaqësuesit e popullit

Të dashur lexues, në artikullin tonë do të mësoni më shumë rreth punës të cilën e bën Kuvendi i Republikës së Kosovës. Po ashtu, do të informoheni edhe për funksionet e tij, që janë të shumta. Arsyja pse ne dëshirojmë t'iu informojmë më shumë për këtë institucion është sepse këtu punojnë të zgjedhurit e popullit që janë të njohur si deputetë. Këta deputetë, janë zëri i popullit i cili i ka votuar dhe zgjedhur ata me vota

kuvendojnë 120 deputetë, të cilët iu përkasin partive të ndryshme, por po ashtu edhe etnive të ndryshme. Prej këtij numri të deputetëve, 100 janë nga kombi shqiptar, ndërsa 20 të tjerë iu përkasin komuniteteve jo shumicë. Këta deputetë kanë detyra dhe përgjegjësi të shumta, kjo sepse ky institucion luan rol shumë të rëndësishëm në jetën e çdo qytetari. Disa nga funksionet kryesore të Kuvendit janë: funksioni përfaqësues, sepse deputetët përfaqësojnë popullin e tyre; funksioni legjislativ, sepse bën miratimin dhe mos miratimin e ligjeve; si dhe funksioni kontrollues, që do të thotë se Kuvendi si institucion ushtron funksion kontrolli ndaj një institucioni tjetër, që është Qeveria. Këtë e bën përmes pyetjeve, të cilat ia parashtron ministrave të cilët janë të pranishëm në seancë plenare. Kjo na tregon shumë për udhëheqjen e vendit tonë, pasi që çdo gjë është e drejtpërdrejtë. Ne po ndahemi me shpresën që këto informata që i mësuat nga ne do t'iu ndihmojnë në të ardhmen.



Këtu kemi shkruar një deklaratë që është shumë e rëndësishme, kjo është deklarata e Betimit të Deputetëve

të lira. Ne mendojmë që është e drejtë t'iu tregojmë se kush mund të kandidojë për deputetët, sepse ndoshta dikush nga lexuesit tanë, dëshiron që në të ardhmen të kandidojë për deputet. Të drejtën për të kandiduar për deputet e gëzon çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës punojnë dhe



Autorët e artikullit



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Dëshmorët e  
Kombit“  
Klasa: V-2  
Vendi: Kamenicë